

Data 13.02.2025

AKT THEMELIMI

1. – Personi juridik "TOÇI CONSTRUACION" sh.p.k me seli ne Elbasan Lagjia Dyli Haxhire, rruga Hysen Peni nr pasurie 8/146/1 zona kadastrale 8526, Shqiperi, mbështetur ne ligjin Nr.9901, dt.14/04/2008, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ne legjislacionin shqiptar ne përgjithësi, vendosen si vijon:

KREU I - EMERTIMI, SELIA DHE AFATI I SHOQERISE

NENI 1

- 1.1 Te themelojë shoqërinë me përgjegjësi te kufizuar, për te zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqëria është person juridik shqiptar, veprimtaria e te cilës rregullohet nga akt themelimi, statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar- ne fuqi.

NENI 2

- 2.1 Shoqëria do te emërtohet "TOÇI CONSTRUACION" sh.p.k.

NENI 3

- 3.1 Shoqëria do te ketë Selinë e saj ne Elbasan Lagjia Dyli Haxhire, rruga Hysen Peni nr pasurie 8/146/1 zona kadastrale 8526, Shqiperi
- 3.2 Selia e shoqërisë mund te transferohet.


NENI 4

- 4.1 Shoqëria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Afati mund te ndryshohet me vendim te Asamblesë se Ortakeve.
- 4.2 Shoqëria "TOÇI CONSTRUACION" sh.p.k gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin e QKB-se.

NENI 5

- 5.1 Shoqëria "TOÇI CONSTRUACION" sh.p.k do te ketë si objekt:
- Punime te ndryshme armatura, kapenteri, suvatime, fino, murature, lidhje hekuri, shtrim me pllaka, veshje sisteme kapote, punime grafiato, izolime, rikonstruksione, punime eletrike dhe hidraulike, punime germimi e te tjera te ngjashme
- Gjithashtu, Shoqëria mund te kryeje çdo lloj veprimtarie apo transaksioni tjetër qe lidhet me pasuri te luajtshme e te paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare te çfarëdo lloji dhe natyre, te nevojshme ose te dobishme për arritjen e objektivit te shoqërisë, qe nuk ndryshon aktivitetin parësor te shoqërisë dhe nuk bie ne kundërshtim e legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 6



- 6.1 Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesën e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e përfitojnë ortakët e saj.
- 6.2 Ortakët themelues përballojnë humbjet shoqërisë deri ne kufirin e vlerës se saj te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne bankat e Shtetit Shqiptar.
- 6.3 Kapitali themeltar për vazhdimin e aktivitetit te shoqërisë është ne shumen 100,000 (njqind mijë) leke, qe i takon ortakut te vetem themelues si me poshtë:
- (a) Individ i VIKTOR TOÇI zotesi te plote juridike per te vepruar me nr ID H10901180H, lindur me 01.09.1971 ne Xibresh dhe banues ne Elbasan ,Lagjia Dyli Haxhire, rruga rruga Hysen Peni zona kadastrale 8526, me vlere 100 % te kapitalit.
- 6.4 Fitimet qe do te evidentohen pas miratimit te bilancit vjetor nga Asambleja e Ortakeve pas zbritjes se taksave mund te ndahen si vijon:
- (a) Fondi rezerve.
 - (b) Shpërblimi qe i takon ortakeve themelues.

NENI 7

- 7.1 Shoqëria mund te hyje ne veprimtari te përbashkëta me shoqëri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti atë te shoqërisë.


NENI 8

- 8.1 Veprimtaria shoqërisë mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, konform me ligjin shqiptar ose te huaj.

KREU II - TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT

NENI 9

- 9.1 Ortaku gëzon këto te drejta kryesore:
- (a) Administrimin e veprimtarisë ne përputhje me akt themelimin dhe statutin.
 - (b) Pjesëmarrjen ne rezultatet e çdo forme dhe sasi te veprimtarisë se shoqërisë e parashikuar ne statutin e saj.
 - (c) Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblesë dhe organet e tjera te shoqërisë.
 - (d) Te heqë dore nga shoqëria. Heqja dore nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqërisë.
 - (e) Te marri pjese ne organet e shoqërisë qe janë ose mund te krijohen nëpërmjet përfaqësuesit te tij ose vete.
 - (f) Te emëroje dhe te shkarkoje përfaqësuesit e tij, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.
- 9.2 Ortaku ka këto detyrime kryesore:
- (a) Te depozitoje kuotën e tij dhe kuotën suplementare ne përputhje me akt themelimin dhe statutin.



- (b) Te marri pjese ne administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve te krijuara nga vete ata.
- (c) T'i japi shoqërisë te dhënat e domosdoshme për përpunimin e çdo objekti te veçante lidhur me veprimtarinë e saj.
- (d) Te kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqërisë.
- (e) Ka detyrimin nëse heq dore nga shoqëria ti njoftojnë vendimin e tij asamblesë 3 muaj përpara dhe duke çduar te drejtën e zgjedhjes.
- (f) Te kryejë shërbimet e domosdoshme për arritjen e objektivave te shoqërisë dhe realizimin e funksioneve te saj.

KREU III – ADMINISTRIMI

NENI 10

10.1 Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakeve.

NENI 11

- 11.1 Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm.
- 11.2 Ne shoqërinë "TOÇI CONSTRUCCION" sh.p.k administrator i shoqërisë do te jete Z. ENIS TOÇI, atësia Viktor, shtetas Shqiptar, lindur ne Gjinar, me date 28.12.1997 dhe banues ne Elbasan, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal J71228041Q madhor dhe me zotësi te plote juridike për te vepruar.
- 11.3 Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej 5 (pese) vjetësh financiare.
- 11.4 Me miratimin e ortakeve mund te emërohen administratore dhe përfaqësues te tjerë te shoqërisë. Administratoret emërohen për një kohëzgjatje prej 5 (pese) vjetësh financiare me përjashtim te rasteve te dorëheqjes ose shkarkimit te parakohshëm.
- 11.5 Administratori ka te gjitha kompetencat për te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqërisë dhe ne emër te saj nëpërmjet akteve qe janë ne përputhje me objektin e veprimtarisë se shoqërisë me përjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo te tretëve për shkelje te ligjeve, për shkelje te statutit apo për faj te tij gjate administrimit te shoqërisë

KREU IV - MBYLLJA E SHOQËRISË

NENI 12

- 12.1 Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e bere nga ortakut, kur gjate tre vjetëve nuk rezulton rentabël si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqërisë.
- 12.2 Shoqëria shpërndahet ne forme riorganizimi ose likuidimi.

NENI 13

- 13.1 Kur shoqëria likuidohet Asambleja e ortakut emëron likuidatorin, dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë se saj ne çastin e miratimit te këtij bilanci te likuidimit. Komisioni i

Likuidimit përbehet nga një ose tre natarë. Pasuritë që janë vene ne dispozicion te shoqërisë me te drejte shfrytëzimi, shiten ne vartësi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat veprimtarisë se shoqërisë e te filialeve te saj dhe fondet financiare ndahen ndërmjet ortakeve ne përpjesëtim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat për kreditorët.

NENI 14

- 14.1 Kur pushon veprimtaria e një filiali, për efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakeve.
- 14.2 Likuidimi i filialeve behet njëloj si për shoqërinë.
- 14.3 Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarisë se filialit te likuiduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqërisë pasi to jene bere pagesat likuidatorëve.

NENI 15

- 15.1 Dispozita te hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen ne statutin e saj.

Ky Akt-Themelimi nënshkruhet me vullnet te lire ne 1 kopje identike ne gjuhen shqipe, dhe secili nga ortakët do te marre një kopje.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

VIKTOR TOÇI,

Viktor Toçi
